

FATJONA MEMI

**VËSHTRIM KRAHASUES I DY VARIANTEVE: *NATA E USTIKËS*,
1989 DHE *NJË NATË DHE DY AGIME* 2002, TË SHKRIMTARIT
PETRO MARKO**

Në mungesë të një tradite të hershme të lëvrimit të romanit në Shqipëri sidomos në vitet '60-'80, pati ndikim të madh romani i realizmit socialist i cili i kufizonte romanit shqiptar burimin estetik, filozofik, letrar dhe shfrytëzimin e shkollave letrare – estetike të letërsisë së shek. XX-të. Por, pavarësisht nga ajo që u botua, një pjesë ishin mbështetës të skemës dhe të tjerë shfrytëzuan përvojën europiane të romanit realist për të sjellë për lexuesin shqiptar vepra me karakter letrar dhe kundër skemave.

Në Shqipëri, për letërsinë dhe gjithë fushat e tjera të dijes, problemi i censurës ishte po aq vdekjeprurës për krijimtarinë, për zhvillimin e saj, sa edhe vetë dënimi, burgosja e persekutimi i krijuesve. Viktimë e censurës ishin me dhjetëra njerëz të dijes, mes të cilëve mendojmë se një ndër më të dëmtuarit ka qenë dhe Petro Marko, vepra e të cilit është censuruar në tre forma: e plotë, e pjesshme dhe në elemente të caktuara të saj.

Romanin "*Një natë dhe dy agime*", shkruar që në vitin 1963, pas një odiseje të gjatë në zyrat e redaksive, autori mundi ta botonte në vitin 1989, me një titull tjetër, metaforik, "*Nata e Ustikës*", me kuptim krejt të kundërt nga i pari, duke shmangur titullin e dyshimtë. "*Agimi vetëm një herë mund të ndodhte si rezultat i një drejtimi politik të udhëhequr nga Partia... Agimi i parë dhe i dytë. Dy agime. E pamundur. Kush mund ta sillte të dytin?*"¹ Sepse agimi për njerëzit nën diktaturën shqiptare duhet të ishte vetëm partia.

Devijimet, shkurtimet, zëvendësimet e ndryshme që na ofrohen në botimin e vitit 1989, duke nisur që nga titulli i romanit, dëshmojnë më së miri procesin "redaktues" që i është bërë veprës, jo vetëm nga autori, si rezultat i kalimit të saj në filtrin e censurës.

Një përjasje, pra një krahasim i materialit faktik i të dy varianteve, qoftë dhe në një pjesë të kufizuar të tij, e bën më të qartë synimin e autorit në variantin e parë dhe "përfitim" që pësoi censurimi i saj në variantin e dytë. Këtë pranëvënie, jo pa qëllim e kemi parë në disa plane dhe elementë, por gjykimin dhe përfundimin mendojmë t'ia lëmë lexuesit të këtyre shënimeve apo të këtij shkrimi.

¹ P. Marko, *Një natë dhe dy agime*, OMSCA, Tiranë, 2002, f. 4.

1. Krahasoni i dy varianteve: “Nata e Ustikës”, 1989 dhe “Një natë dhe dy agime” 2002

“Nata e Ustikës” 1989²

“Një natë dhe dy agime” 2002³

1. Ndryshim i titullit

Titulli lidhet me anë të fjalës agim me përmbajtjen, brenda së cilës zbulohet simbolika e tij, fillimisht si formë e drejtpërdrejtë: si dukuri kohore, 13320 agime të jetuara fizikisht, dhe me pas në kuptimin e figurshëm: simboli që shënon fillimin e ri, lirinë, “agimet e jetës”, një faqe e re në jetën e heroit, Andreas.

2. Transformime:

a) në strukturën e romanit

Pjesa e tretë (f. 309)	Kapitulli IV (f. 480)
Pjesa ka 47 faqe dhe 4 kapituj.	Kapitulli ka 72 faqe dhe 3 nënkaptuj.

b) Transformim i fjalive:

“Dashuria në këtë skëterrë është e vetmja dritë.” (f. 222)	“Dashuria në këto rrethana është e përjetshme... E përjetshme.” (f. 366)
“Unë kisha nevojë të takohesha sa më parë me shokët.” (f. 298)	“Unë kisha nevojë të takohesha sa më parë me Sonjën. Me shokët.” (f. 456)
“..kur u çelën sytë e Sonjës, m’u duk sikur u çelën dyert e agimit.” (f. 334)	“Sonja hapi sytë. Për mua ky ishte vetë agimi” (f. 513)
“Si e harrova fare Sonjën. Ta kishim ndarë së bashku këtë gëzim.” (f. 351)	“E para gjë që duhet të bëja, ishte të gjeja sa më parë Sonjën.” (f. 545)
“Unë nuk kisha nge të merresha me Sonjën dhe me Dorën, se pothuajse çdo orë dilja nga shtëpia me Gjigantin e takoheshim me punëtorë antifashistë nga Papinjoja.”	“Unë nuk qëndroja me Sonjën dhe me Dorën, se pothuajse gjithë kohën dilja nga

² P. Marko, *Nata e Ustikës*, ShB. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1989.

³ P. Marko, *Një natë dhe dy agime*, OMSCA, Tiranë, 2002.

(f. 340)	<i>shtëpia me Gjigantin e takoheshim me punëtorë antifashistë nga Papinjoja.</i> ” (f. 520)
“Kazma bënte duk – duk në atë tokë gërxxh.” (f. 175).	“Dhe, kur kazma bënte duk- duk në atë tokë gërxxh, më dukej sikur ato goditje binin në zemrën time... Rrihnin zemrën time.” (f. 305)
“Shumica qëndronin mbi gurët e varreve.” (f. 175)	“Shumica qëndronin mbi gurët e varreve, mbi kryqet e shumta e të dendura.” (f. 305)

Ajo që vihet re më lart është copëtimi i çdo fjale simbol nga përbërësit e tjerë kontekstualë. P.sh. Fjala simbol “agimi”, zhvendoset brenda fjalisë duke i zbehur kuptimin kryesor.

c) Koha brenda veprës:

Objektive, e dhënë prej shkrimtarit subjektivisht në ngjashmëri me kohën historike. Pra, është krijuar një shëmbëllim i kohës së viteve të të luftës antifashiste. Retrospektivë.	Rrëfimi është sipas një kohe lineare, të vazhdueshme.
--	---

3. Janë censuruar:

a) Kapitujt:

Mungojnë	Kapitulli i parë: “Agimi” (f. 7-53) Kapitulli i fundit: “Agimi i dytë” (f. 552-560)
----------	--

Kapitulli i parë, “Agimi”, pas censurimit, zëvendësohet me kapitullin e dytë me titull: “Nata”. Kështu fjala-simbol “agim” zëvendësohet me fjalën “natë”. Nata, gjumi, ëndrra, nata e një të burgosuri dhe nata e njeriut të lirë, kanë ngarkesë kuptimore të thellë për njeriun në kushte krize ekzistenciale dhe nata kthehet në një përpjekje për t’u ndjerë i lirë, por për autorin nuk është ky

kuptimi i lirisë së vërtetë, është nevoja për të kujtuar dhe jo për të harruar, prandaj heroi nuk e pëlqen natën, ai ndihet i lirë vetëm kur kalon nga shtegu i dashurisë.

Ndërsa kapitulli i fundit “*Agimi i dytë*”, pas censurimit nuk është zëvendësuar me një tjetër. Vepra mbyllet me kapitullin e katërt të pjesës së tretë.

b) Fjali që mbartin një ngarkesë kuptimore politike:

Mungon (f. 328)	“Një regjim që s’ka asgjë të përbashkët me popullin e me kombin, s’mund të mbahet me gjak, me hu e me litar, por patjetër që do t’i vijë fundi...” (f. 501)
-----------------	---

c) Dialogje në analogji me sistemin totalitar të kohës janë shndërruar në një fjali:

Luçia: - S’ka njeri të lirë në botë.” (f. 259)	“Luçia: - S’ka njeri të lirë në botë. / Sonja: -Ka! / Fiorela:- Ku? Sonja:- Ata që s’e pranojnë, e urrejnë dhe e luftojnë skllavërinë dhe fashizmin, ata janë të lirë... kryelartë.” (f. 413)
---	---

d) Paragrafë me elemente autobiografikë:

Mungon (f. 84)	“Deti i paanë sikur na kujtonte vuajtjet tona të paana. Deti, me ngjyrën e tij kaq të dashur, më sillte ndërmend detin e fshatit tim, kaq të dashur. Dhe prangat... dhe zinxhiri i rëndë më bënë që të rikujtoja letrën e vogël të babit që shkruante nga Ustika...” - Shiko si duket Ustika!- më pëshpëriste Alqi.- Si një copë tapë e madhe mbi ujë... Mua s’më dukej si një tapë mbi det. Më dukej si një gur varri mbi det. Tamam si një gur varri mbi det. Si një gur varri mbi një shkëmb uji...” (f. 194)
----------------	--

Këto vijnë të ndërputhura natyrshëm në botimin e plotë, në funksion të ndërtimit të personazhit, pra jo thjesht si dëshmi e fakteve jetësore.

e) Fjalë të rëndomta:

Mungon (f. 116)	-Po si do t’ia bëjmë për dru? Si do ta ndezim zjarrin? Taqi përgjigjej: -Me bajgat e lopëve... Kam parë sot që
-----------------	---

	disa kishin mbledhur bajga, i bënin si bukëfiqe e i vinin në diell të thaheshin... Bexheti qeshte. Taqi përgjigjej: -Kishte dhe uturakë të mëdhenj... Të marrim një e ta bëjmë mangall. Bexheti qeshte. Kur Alqi thoshte: - Të pyesim don Çuçon. Ai i di vrimat... – Gjithë vrimat e haleve i di ai don Çuçoja... (f. 234)
--	--

- f) Paragrafë, në të cilët në vend të veprimit e ngjarjes mbizotëron monologu i brendshëm, pa dëgjues tjetër përveç vetes, i ndërtuar kryesisht me pyetje retorike. Mbizotërojnë censurime që i përkasin linjës së dashurisë.

Mungon (f. 112)	“Turbekulozë, tumore, etje, uri, supë me ujë deti, dizenteri, çmenduri... Vetëm zëri i saj - muzikë. Zëri i Sonjës.” (f. 229)
Mungon (f. 132)	“-Ja që na u fejove Andrea. “Pse ma tha me këtë ton? Tallet me mua?” Po Kadriu pse i tha këto?” (f. 252- 253)
Mungon (f. 141)	“Mendja ime bënte dy punë: urdhëronte sytë të shprehnin kënaqësi për ato që veshi nuk dëgjonte, dhe trillonte skena të takimit të parë më Sonjës, si të fejuar. “Si do t’i them? E fejuara ime, ku je? Pse u vonove? E fejuara ime, a dalim shëtitje, veç jo në ‘Sheshin e ndërgjegjeve të shituara’. Doktori:(Me zë si më të qarë) -Dhe ka ditë që s’e shoh dot mëshqerrëzën time. Unë trilloja: ‘Po si do dalim para të tjerëve si të fejuar? Ku do takohemi? Unë nuk dua ta sjell këtu. Ajo është kaq e brishtë, e dëlirë, si lule...’ ... Doktori: -..Pse s’më thua një fjalë Andrea? Kur kam nevojë për të ajo s’më shikon fare... fare! ... Unë, i habitur, përmendesha dhe pyesja veten: ‘Është në rregull ky apo ka rrjedhur fare? Ç’dashuri bën ky me atë grua të moshuar, djali më i madh i së cilës është pothuaj sa unë?’ Doktori: -Pse s’më flet? Pse s’më ndihmon? Unë: -Si urdhëron! Po si? Doktori: - Si? Tregomë si të sillem me të. Je i pari pas

	<i>kaq vjetësh që ia çel dyert e zemrës sime të zhuritur. Ç'të bëj?" (f. 263-264)</i>
Mungon (f. 147)	<i>"Qëndrova në vendin tim. Pse më vinte turp nga vetja? Ç'po ndodhte me mua? Pse sikur diçka më ndalonte t'a shikoja Sonjën? Pse tani më dukej si një Sonjë tjetër?" (f. 270)</i>
Mungon (f. 152)	<i>"Pse? Nuk i pëlqen që quhemi të fejuar? Pse qesh në këtë mënyrë pak si ironike? Tallet?" (f. 276)</i>
Mungon (f. 157)	<i>"E vërteta është se s'para më vinte mirë të flisja për Sonjën. Po megjithatë u fola shokëve për ç'pashë e ç'dëgjova... sigurisht jo ato që i ruante zemra të kyçura vetëm për Sonjën. Kur mbeta vetëm me Ilon, i fola për porositë e shokëve jugosllavë. Ai më dëgjonte. Hera herës më hidhte nga një shikim. Tundte kryet. Fytyra e tij e mbushur shprehte kënaqësi. Fërkoi duart. Sa mirë e kanë menduar. Të dëgjosh radio-Moskën... Për ne do të jetë shpëtim." (f. 283)</i>
Mungon (f. 184)	<i>"Më pëlqen shumë këtu! - Andrea!- dhe më pa në sy. – Pse jemi kaq egoistë? Sonja: - E pashë që nuk i erdhi mirë Zorës dhe Mirkës. "Ti më e vogël se ne dhe u fejove...! Shko shko e zbavitu, kurse ne..." Unë: (Pa zë) "Pse e hapi këtë bisedë kjo? Po faji është edhe i imi. Pse s'fola unë i pari e t'i thosha: "Sa mirë këtu. Vetëm unë dhe ti. Sa e kam pritur këtë çast! Kur jam me ty, më duket sikur ky shkëmb lundron në këtë det të gjerë dashurie...' Pse jemi egoistë ne? Sonja: Ja! Dalim këtej. Në këtë qetësi çlodhëse. Shohim këtë anë të ishullit... Kurse të tjerët vijnë vërdallë në ato baraka të qelbura, ku të ha të gjallë miza dhe të mbyt kutërbimi." (f. 315)</i>
Mungon (f. 187)	<i>"Përsëri e mori gurin e saj. E hodhi në anën tjetër.... dhe vija re se si kërcente gjiri i fryrë, që siç dukej, s'kishte mbajtëse." (f. 320)</i>
Mungon (f. 204)	<i>"Më bëri të më erreshin sytë dhe të heshtja... të frenoja me dhimbje dëshirën e ëndërruar të buzëve të mia... Ajo m'i nguli sytë në gojën time gjysëm të çelur dhe, si e pushtuar nga ethet e jakut, priste..." (f. 340)</i>

Mungon (f. 246)	<i>“Po duart e saj më shtrënguan aq fort rreth qafës, aq me forcë dëshire dhe dashurie, dashurie e dëshire, sa as unë e as ajo s’kishim më pikën e logjikës... S’kishte mbetur më asgjë misterioze...” (f. 395)</i>
Mungon (f. 203)	<i>“Takimet e mia të shpeshta me Sonjën kishin krijuar legjenda zilie dhe dhembshurie. –Janë të dashuruar që në djep! - Romeo e Zhuljeta të Ustikës!... E ç’ nuk bën dashuria! Ajo shkatërroi Trojën!- Musolini vdes për sinjorina Petaçin... ... Tani pothuaj të gjithë na njihnin. Ngado që kalonim, na përshëndesnin: - Rroftë dashuria! – Ah, rini, rini! – I pari çift i vërtetë në këtë kuplara! – Vdekja ju ndaftë!” (f. 339-340)</i>
Mungon (f. 265)	<i>“–Sonja ! Sonja! – Oh, Andrea! - dhe lëshoi një psherëtimë aq të thellë sikur deshi të nxirrte tërë trishtimin e saj. ... E pastaj do të putheshim, do të merrnim nga ngrohtësia e njëri- tjetrit duke dëgjuar vetëm rrahjet e shpejta, të stuhishme të zemrave tona.” (f. 420-421)</i>

g) Përshkrime tronditëse mbi mjedisin ku veprojnë personazhet

Lufta mbart dramën dhe ironinë që vende të bukura si Roma, Venecia prodhonin ushtri kaq të egra.

Autori na ofron përshkrime tronditëse mbi ishullin ku rraskapitja arrinte kulmin, me ndërtesa të vogla ‘të mbledhura si në një lugë’, si dhe një sërë pjesësh që pasurojnë përshkrimin realist të situatave, ngjarjeve, karaktereve si: ndjenjat e miqësisë dhe xhelozisë midis shokëve, thirrjet euforike të të burgosurve ordinerë, trimëria që tregon heroina në sfidën me vdekjen, paralelizma pozitivë midis partizanëve shqiptarë dhe atyre të huaj, sllovenë, malazezë, triumfi i fitores dhe paragrafë plot me pasthirrma kundër diktatorit.

Mungon (f. 173)	<i>“Ah, që nuk i bëmë dot një arkivol! Sa është ora? (f. 302)</i>
Mungon (f. 175)	<i>“Unë kisha përballë një qiparis. Dhe ndjeva erën të ligjëronte majë tij. Era e detit. E detit që shtrihej, ja aty përballë shkëmbit, që ishte pak metra nga muri...”</i>

	<i>Mendoja për varrin e tim eti. Për Maqon. Për ligjëratën. Për varrin e paçelur të Antonios së gjorë. Dhe, kur kazma bënte duk - duk në atë tokë gërxh, më dukej sikur ato goditje binin në zemrën time... Rrihnin zemrën time. Tamburin e ndjenjave të mia.” (f. 305)</i>
Mungon (f. 201)	<i>“Përsëritet nga radio Moska! ‘O Ustika e zinxhirëve! Dëgjoje, dëgjoje zërin e jetës! Dëgjojeni, o të mjerë! Dëgjojeni o, të humbur!’” (f. 336)</i>
Mungon (f. 225)	<i>“Pse mendoj për pleqtë, për këta baballarë partizanësh? Apo pamja e tyre hijerëndë, në këtë Lazaret që i ngjan kolibes së mortjes, duket si një gjë e çuditshme...? Dhe ja dëgjova një melodi ... një kor me shumë zëra, e sidomos baritonë, ‘Gospodin pomillaj! Gospodin pomillaj!’ që buçiti, gjëmoi, oshëtiu e u ngrit lart e më lart, sa m’u duk sikur psallte ishulli dhe qielli.” (f. 370)</i> <i>Kori shtohet nga baritonët, sikur nxirrnin dufin e tyre, e mbushnin më fort e më fort psallmin mortor: Gospodin pomillaj! Gospodin pomillaj! (f. 371)</i>
Mungon (f. 261)	<i>“—Amedeo! Pse ke vdekur? – Që ti të hash racionet e mia! Këto plaçka, - dhe tregonte këmishën e murrme dhe pantallonat prej cope çadre, -mos m’i zhvesh... M’i lër se tani është dimër dhe s’më pëlqen të fle lakuriq. Lakuriq është mirë në shtrat me vajzën e padrones. Shëët, se na dëgjon prifti... A i je rrëfyer? – Asnjëherë! – Gabim! Shko para se të vdesësh edhe ti... – Jam ateist. Besoj vetëm tek kjo! - Dhe tregonte bonon e racionit. – E shes! Kush e blen? Dua verë!” (f. 416)</i>

h) Paragrafë ku paraqitet heroi në raport me vdekjen, mendimet e tij mbi të dhe frika prej saj

Mungon (f. 176)	<i>“Mjaft është! Këto fjalë pa rëndësi, sa rëndësi kishin! Ajo heshtje e atyre qindra e qindra të dënuarve sa fliste! Ç’mendonin gjithë ata shokë që dëgjonin vetëm duk-dukun e kazmës? Po unë, unë, duke parë gjithë ato fytyra të thara petë, ç’mendoja? “Ja Maqoja. Edhe pak çaste ai do të mbulohet. Dhe ne do të kthehem. Ai do të qëndrojë aty. I mbuluar... I mbuluar... I mbuluar....” (f. 307)</i>
Mungon	<i>“Varret tona janë panteone të jetës. Kalvari ynë është</i>

(f. 177)	<i>rruga e jetës. Theoria jonë është flamuri i jetës. Varri juaj flet gjuhën e përhershme të mundimeve tona për lumturinë e njeriut.</i> (f. 308)
Mungon (f. 182)	<i>“Sa ka të bëjë një prekje e vogël e gishtërinjve.”</i> (f. 313)

i) Përshkrimet e dashurisë në raport me vdekjen:

Mungon (f. 206)	<i>“Po lodhesha. Nisën të më lodhnin mendimet, që më vërshonin si vargu i dallgëve të zemëruara. Po tani? Çdo të bëja? Si do të dilja?</i> ... <i>Prisja dallgën, t'i hipja në kurriz e të shikoja nga shkoi Sonja... Humbiste e përsëri dilte te shkëmbinjtë që zbardhnin nga shkumëretë e larta.”</i> (f. 344)
Mungon (f. 209)	<i>“Megjithëse biseda u ndez nga benzina që hidhte Taqi mua nuk më vinte keq fare. I dëgjoja: Gabimi i parë: që u lave në ata shkëmbinj! – Po sikur të ishe mbytur?</i> ... <i>Shpëtoi se ishte Sonja aty...”</i> (f. 348)
Mungon (f. 325)	<i>“Ai fliste dhe unë s'mund ta dëgjoja më. Koka më gjëmonte.</i> <i>...Unë, me të dëgjuar dy fjalët e saj “më dhemb” e me të parë sytë e saj të lodhur e të trishtuar, fola pa menduar.”</i> (f. 495)
Mungon (f. 345)	<i>“Mendoja për Sonjën dhe më vinte të çahesha, se e shikoja që keqësohej, kurse ajo nuk bindej të qëndronte me Dorën ose ku të dëshironte, për të vazhduar kurat që i thoshin mjekët dhe si në ëndërr më bëhej sikur ngrihesha nga shtrati, sikur veja tek ajo dhe i futesha në shtratin e saj, e përqafoja, e puthja, e përkëdhelja, i thosha njëmijë fjalë të ëmbla. Dëgjoja kollën e saj, rënkimet e saj... “Pse të mos vete t'i futem në shtrat? Më mirë ...Do ta ngroh ...Do ta fërkoj në supe e në shpinë...! Se i pëlqen...</i> ... <i>Pse më tha që i ka ditët të numëruara? Vendos! Vendos! Nuk e sheh se ajo ta tha copë: po vdes... Si në film të pëlqej kështua?”</i> (f. 529-530)

Mungon (f. 347)	<i>“Më mundonte mendimi se mund ta humbisja përgjithmonë...</i> ... <i>-Po, Bozho! Po ti, a dashuron? – Po! E kam lënë atje... Ose ende lufton maleve, ose do të jetë vrarë! – dhe u vrenjt në fytyrë duke shikuar majën e Sardos, që zbardhëllonte nga dëbora.” (f. 534)</i>
-----------------	--

j) Fjali ku del filozofia e mbijetesës

Mungon (f. 262)	<i>“Biseda u kthye për të nesërmen. E nesërmja na mban gjallë. - Do të shëtisim të lirë ku të duam!</i> ... <i>- Po kufijtë etnikë? – pyeta unë.</i> ... <i>Republikat Socialiste të Bashkuara të Ballkanit është shpëtimi, është qëllimi dhe lufta jonë...” (f. 417)</i>
-----------------	--

Censurimi i romanit në elemente të subjektit, e ka çuar atë drejt një fundi tragjik duke dhënë një ide të kundërt dhe duke i mohuar autorit lirinë e fjalës artistike dhe lexuesit lirinë e marrjes së mesazheve universale. Prandaj lexuesit i serviret një fund me kah absolutisht të kundërt nga ai i shkruar nga autori. Linja e dashurisë në romanin *“Një natë dhe dy agime”*, ka një fund të lumtur, ndërsa në botimin me titull *“Nata e Ustikës”* fundi është tragjik. Censura e ka vendosur autorin të gjejë një zgjidhje tjetër. Një heroinë me kombësi jo shqiptare që vdes, në vend të një heroine të huaj, që martohet me një shqiptar. Kështu vepra humbet mundësinë për të transmetuar mesazhet e saj, të triumfit të dashurisë, pa dallime kombësie, pa dallime politike, të dashurisë si ndjenjë njerëzore, para së gjithash. Ndëshkimi është i trefishtë: autor – vepër – lexues.

BIBLIOGRAFI

- A. Aliu, *Koha dhe krijuesi*, Rilindja, Prishtinë, 1975.
P. Marko, *Një natë dhe dy agime / Nata e Ustikës*, OMSCA-1, Tiranë, 2002.
P. Marko, *Nata e Ustikës*, ShB. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1989.

SUMMARY**COMPARATIVE LOOK OF TWO VARIANTS: *NATA E USTIKËS*, 1989
AND
NJË NATË DHE DY AGIME, 2002, OF WRITER P. MARKO**

Petro Marco's novels, as we saw, were censored in three forms: full, partial and in certain elements of it.

Comparing the actual material of two options: "*One night and two daybreaks*" (1989) and "*Night of Ustika*" 2002 we see deviations, cuts, various replacements offered in the 1989 edition, starting with the title of the novel, transformation of the sentences, which are in analogy with the totalitarian system of the time, removing of monologues, common words and paragraphs with autobiographical elements with chocking descriptions of the environment where the characters do the situations, events, characters, the appearance of love in relation to death and survival philosophy etc. All these clearly show the process "editor", who is doing the work, not only by the author, but also the result of its passage through the filter of censorship.

Coming to the conclusion we can say that censorship has affected mainly the love line by removing part of the text and changing the subject from a happy ending to a tragic end. As a result the novel has lost the opportunity to transmit its messages: the triumph of love regardless of nationality and political differences. The punishment is threefold: author –novel– reader.

